



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 3759 Prot.

Tiranë, më 22 / 12 /2025

V E N D I M

Nr. 65, datë 22.12.2025

P Ë R

MIRATIMIN E PROPOZIMIT PËR HAPJEN E PROGRAMIT TË CIKLIT TË TRETË TË STUDIMIT “DOKTORATË” NË INXHINIERI CIVILE, ME NËNFUSHË INXHINIERI STRUKTURASH DHE INFRASTRUKTURË, NË FAKULTETIN E INXHINIERISË SË NDËRTIMIT, NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK TË TIRANËS

Mbështetur në Ligjin Nr. 80/2015, datë 22.07.2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Vendimin Nr. 41, datë 24.01.2018, "Elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë", i ndryshuar, Udhëzimit të MAS Nr. 1, datë 14.01.2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të Arsimit të Lartë, degëve të tyre, njërive kryesore dhe programeve të studimit si dhe për ndarjen ose bashkimin e Institucionit të Arsimit të Lartë" i ndryshuar, VKM 112, datë 23.02.2018, e ndryshuar dhe Rregulloren e Studimeve të Doktoratës të UPT-së, Senati Akademik në mbledhjen e datës 22.12.2025,

VENDOSI:

Miratimin e propozimit për hapjen e programit të ciklit të tretë të studimit “Doktoratë” në Inxhinieri Civile, me nënfushë Inxhinieri Strukturash dhe Infrastrukturë, në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit, në Universitetin Politeknik të Tiranës, si dhe miratimin e pesë projekteve kërkimore-shkencore mbi të cilat mbështetet ky program studimi, me titull si më poshtë:

1. Analiza e strukturave të përbëra (çelik-beton);
2. Sjellja e kolonave prej betoni të armuar me shufra GFRP dhe me agregat nga betoni i ricikluar;
3. Bashkëveprimi truell-strukturë i urave me themele të thella në zona me sizmicitet të lartë;
4. Strategji për reziliencë dhe zvogëlimin e riskut sizmik në Shqipëri;
5. Vlerësimi i riskut Sizmik të Urave dhe Zhvillimi i Strategjive të Mirëmbajtjes dhe Investimeve për Infrastrukturën Rrugore.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Prof. Dr. Akli Fundo